



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P.799/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.12.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “MB Kurti” shpk nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-28383-10-02-2017, me objekt: “*Blerje dru zjarri*”, me fond limit 9 268 000 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 27.10.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

Ankimues: Operatori ekonomik “Pinderi” shpk
Adresa: Korçë Drenovë, Rruga Nacionale Korçë Ersekë, Km Zona Kadastrale 1538 Nr. I pasurisë 96/16

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Pogradec
Adresa: Lagja Nr .2, Bulevardi “Rreshit Çollaku” Pogradec

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë, 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomikë ankimues.



Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.10.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-28383-10-02-2017, me objekt: “Blerje dru zjarri”, me fond limit 9 268 000 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 27.10.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

II.2. Në datën 27.10.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 02.11.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

Naim Skodi	nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
- MB Kurti	8.668.750lekë skualifikuar
- Pinderi	9.015.447lekë skualifikuar
- Kopaçi	9.244.830 lekë kualifikuar

II.4. Në datën 02.11.2017 operatori ekonomik “Pinderi” shpk, është njoftuar për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- 1.1. Në DST është kërkuar "2.4.3 Te kete ne pronesi ose me qira, 1 (Një) automjet per transportin e druve te zjarrit". Në përmbushje të këtij kriteri O.E PINDERI SHPK ka paraqitur dokumentacionin e mjeteve me targa AA482 GR dhe AA617IR. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mjeteve rezulton se të dyja mjeteve iu ka përfunduar certifikata e kontrollit teknik te mjeteve, konkretisht per mjetin me targa AA482GR certifikata e kontrollit teknik ka perfunduar me date 18.Gusht.2017 dhe per mjetin me targa AA617IR certifikata e kontrollit teknik ka perfunduar 20 Tetor 2017. Pra, O.E PINDERI SHPK nuk disponon asnje mjet te rregullt me te cilin te kryeje levrimin e druve te zjarrit ne shkollat e qytetit te Pogradecit dhe te Njesive Administrative. Referuar nenit 79 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të kalojnë në kontrollin teknik vjetor dhe atë periodik. Kontrolli teknik vjetor do të kryhet një herë në vit, për të gjitha mjetet me motor dhe rimorkiot. Për mjetet e reja me motor që hyjnë në Shqipëri, kontrolli i parë teknik do të kryhet brenda një viti nga data e regjistrimit. Pas kësaj periudhe ky kontroll kryhet për çdo vit.
- 1.2. Në DST është kërkuar "Një dokument që vërteton që subjekti juaj, i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2016 dhe 2017, lëshuar Administrata e Qeverisjes Vendore". Në përmbushje të këtij kriteri O.E PINDERI SHPK ka paraqitur vertetim nga Bashkia Korçe me nr. 4441 prot, datë 24.10.2017, ku vertetohet fakti se subjekti ka paguar vetem tarifën lokale per vitin 2016 dhe 2017. Pra, operatori ekonomik PINDERI SHPK deshmon se ka likuajduar vetem tarifën lokale (vendore) dhe jo edhe taksat vendore, sic jane - Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin.
- 1.3. Në DST është kërkuar "Referuar Ligjit Nr.10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", i ndyshuar me ligjin Nr.60/2014, shtojca 1, A) ID 7.10 Veprimtarite e lendes se drurit - pika b., operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me licencën ose lejen përkatëse, gjithmone duke respektuar dispozitat e ligjit te sipercituar. Në leja me nr. serial PN-2795-05-2016 e paraqitur nga O.E PINDERI SHPK, vendi i kryerjes se veprimtarise eshte ne adresa: Stabiliment druri, rruga nacionale Korçe - Erseke, Km i 4, perballe me fabriken e tullave. Nga verifikimi i ekstraktit te QKB rezulton se kane ndodhur ndryshimet e meposhtme ne Adresat e Aktivitetit: Ështe Shtuar Adresa: "Korçe; KORÇE; ; Drenove; DRENOVE; Rruga Korçe - Erseke, Km 4, Zona Kadastrale 1538, Nr. Pasurie 96/16, Tek Zapet; " Ështe Hequr Adresa: "Korçe; KORÇE; Drenove; DRENOVE; Stabiliment druri,rruga nacionale Korçe-Erseke,km i 4- tert,perballe me fabriken e tullave. Për sa më sipër O.E PINDERI SHPK ushtron veprimtarinë e lendes se drurit, shtojca 1, A) ID 7.10, në një adresë tjetër dhe jo ne adresen e percaktuar ne leja me nr. serial PN-2795-05-2016

II.5. Në datën 07.11.2017 operatori ekonomik "Pinderi" shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me pretendimet si më poshtë:

[...]

"Pinderi" shpk argumenton me fakte të hollësishme se arsyet e referencës së mësipërme nuk qëndrojnë.

“Pinder” shpk ka më shumë se një automjet për lëvrimin e druve të zjarrit dhe ka dorëzuar më datë 26.10.2017 ora 16:33 dokumentin me emërtimin *Lejet e Qarkullimit të automjeteve pdf*, ku vërteton se ka të gjitha automjetet me leje qarkullimi dhe janë kryer kontrollet teknike për secilin automjet automjetet janë :

AA617IR me kontroll teknik 21.10.2017; AA482GR me kontroll teknik 18.08.2017; AA396Kime kontroll teknik 29.07.2017; ACR596 me kontroll teknik 29.07.2017; KO8637B me kontroll teknik 18.05.2017. Këtë dokument po e bashkangjit me fotopopje të lejeve të qarkullimit që kam dorëzuar elektronikisht.

“Pinderi” shpk ka dorëzuar më datë 26.10.2017 ora 16:37 dokumentin me emërtimin *Vërtetim për pagesën e taksave vendore pdf*. Drejtoria e përgjithshme e taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Korçë ka këtë format për të pajisur me vërtetime subjektet që bëjnë kërkesë që nuk kanë detyrime në këtë vërtetim përfshihen të gjitha detyrimet e shlyera si: tarifata lokale si dhe taksat vendore (taksa mbi ndërtesën, taksa mbi tokën bujqësore, taksa mbi truallin) Këto mund ti verifikoni pranë Bashkisë Korçë.

Po ju bashkangjit fotokopje të vërtetimit si dhe mandat pagesat e shlyera të detyrimeve.

“Pinderi” shpk ka dorëzuar më datë 26.10.2017 ora 16:34 dokumentin me emërtimin *“Leje Mjedisore pdf”*. Leja mjedisore që kemi dorëzuar me numër serial PN-2795-05-2016 ka të njëjtën adresë me anë të Certifikatës së Regjistrimit para datës 17.05.2017. “Pinderi” shpk ka vetëm një adresë kryesore që kryen veprimtarinë kjo mund të vërtetohet nga Ekstrakti Historik i regjistrimit Tregtar që nuk ka adresë tjetër dytësore dhe që kryen aktivitetet në adresë me pronësi të vetë.

Më datë 17.05.2017 me numrin e çështjes CN288269-05-17 sipas Ekstraktit Historik të Regjistrimit Tregtar nuk është bërë ndryshim adresës kryesore por është përditësuar adresa e saktë sipas certifikatës së pronësisë që kërkohej nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve që është detyrim ligjor që jemi njoftuar në mënyrë elektronike të tatimeve. Adresa kryesore dhe e vetme ku kryhet veprimtaria e subjektit “Pinderi” shpk që është në certifikatën e pronësisë është dorëzuar përpara datës 17.05.2017 në Bilancin e vitit 2016 që është dorëzuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve si dhe që e kam dorëzuar dokumentin me emërtimin *Bilanc 2016 pdf* më datë 26.10.2017 ora 17:00.

Në bazë të deklaratës, fakteve dhe argumentave që po ju dërgoj kërkojmë nga ana juaj të bëhet rivlerësimi i tenderit në të kundërt do ndjekim hapat e mëtejshëm ligjorë.

II.6. Autoriteti Kontraktor me shkresën nr. 3929/1 prot datë 10.11.2017 (vendimi nr.578prot., datë 10.11.2017), i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim të shqyrtimit të ankesës autoriteti kontraktor vendos të mos e pranojë ankesën.

II.7. Në datën 21.11.2017 operatorit ekonomik ankimues “Pinderi” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik ankimues, në lidhje me përgjigjen e kthyer nga autoriteti kontraktor argumenton si më poshtë:

[...]

Pas marrjes së mesazhit Brenda afatit ligjor të përcaktuar në datën 07.11.2017 kemi paraqitur ankesë në AKku parashtrijmë në mënyrë të hollësishme faktet për të cilat ne nuk duhet të skualifikohemi. Me vendimin nr. 578 datë 10.11.2017 AK-ja Bashkia Pogradec ka shqyrtuar ankesën e paraqitur dhe ka vendosur mospranimin ankesës duke e quajtur të drejtë skualifikimin e

bërë. Duke mos qënë dakord me këtë vendim të Bashkisë Pogradec dhe duke konsideruar të paligjshëm skualifikimin e tij i drejtohet me këtë ankesë KPP-së.

“Pinderi” shpk argumenton fakte të hollësishme se arsyet e skualifikimit të paraqitura në vendimin nr. 578 datë 10.11.2017 të Komisionit të Autorizuar për Shqyrtimin e Ankesës nuk qëndrojnë sepse:

Së pari ky Komision shpjegon se “Pinderi” shpk nuk disponon asnjë mjet të rregullt me të cilin të kryejë lëvrimin e druve të zjarrit në shkollat e qytetit të Pogradecit dhe Njësi Administrative. Për këtë qëllim në mënyrë abusive dhe tendecioze ai i referohet vetëm dy mjeteve me targa AA617IR dhe AA482GR duke pretenduar se atyre iu ka përfunduar certifikata e kontrollit teknik. Ndërkohë e vërteta është ndryshe. “Pinderi” shpk ka dorëzuar elektronikisht në datë 26.10.2017 ora 16:33 dokumentin me emërtimin “Leje qarkullimi të automjeteve pdf”. Në këtë document janë hedhur lejet e qarkullimit dhe kontrollet teknike për 6 automjete që zotërohen nga ky operator nga një automjet që ka kërkuar autoriteti kontraktor. Konkretisht automjetet për të cilat janë paraqitur dokumenta në tende janë:

AA617IR me kontroll teknik 21.10.2017; AA482GR me kontroll teknik 18.08.2017; AA396Kime kontroll teknik 29.07.2017; ACR596 me kontroll teknik 29.07.2017; KO8637B me kontroll teknik 18.05.2017.

Pra ky argument i përdorur nga KSHA-ja nuk qëndron.

Së dyti Komisioni në vendimin e tij argumenton se “Pinderi” shpk nuk vërteton se ka paguar taksat vendore pranë Bashkisë Pogradec. Gjithashtu argumentohet se “Pinderi” shpk nuk ka paguar taksën për tokën buqësore për pasurinë nr. 96/16sip totale 3150m². Edhe këto argumentime të komisionit janë abuzive dhe në kundërshtim me dokumentat që operatorin ynë ekonomik ka paraqitur në tender. Operatorit ekonomik “Pinderi” shpk nuk mund ti kërkohej të paraqesë vërtetim që tregon se ka shlyer taksat vendore pranë Bashkisë Pogradec pasi ky është subjekt i regjistruar dhe që ushtron veprimtarinë e tij në territorin e bashkisë Korçë. Ky fakt provohet edhe ekstrakti i regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB-ja. “Pinderi” shpk ka depozituar në dokumentacionin e tenderit datë 26.10.2017 ora 16:37 vërtetimin lëshuar nga Bashkia Korçë ku tregohet se ky subjekt nuk ka detyrime të pashlyera ndaj Bashkisë Korçë. Ky vërtetim është format tip që Bashkia Korçë përdor për të pajisur subjektet e interesuar me vërtetime për pjesmarrje në tendera. Ky vërtetim tregon se “Pinderi” shpk nuk ka detyrime të pashlyera qofshin këto tarifa apo taksa lokale. Nqs do të ishte ndryshe Bashkia Korçë do të tregonte se janë shlyer tarift dhe jo taksat lokale apo anasjelltas. Nqs Autoriteti Kontraktor Bashkia Pogradec do të kishte paqartësi me këtë fakt mund të verifikonte shumë kollaj pranë Bashkisë Korçë. Për më tepër ne kemi paraqitur edhe të gjitha mandat pagesat për tariaft dhe taksat branë Bashkisë Korçë në Raiffeisen Bank.

Edhe pretendimi se nuk është paguar taksa për pasurinë 96/16 me sip totale 3150m² është i paargumentuar dhe i pabazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga ana jonë. Kemi paraqitur mandat pagesën e lëshuar nga Raiffeisen Bank pagesë e bërë në datën 23gusht 2017.

Sqarojmë se pasuria 96/16 me sip 3150m² nuk është tokë arë por truall pasi vërtetimit të lëshuar nga Këshilli i Qarkut Korçë kjo pasuri rezulton të jetë e klasit të 8 që do të thotë nuk është tokë arë por truall. Thëksojmë që taksa për truallin është më e lartë se e tokës arë. Me mandat pagesën e 23gushtit 2017 vërtetohet se është paguar midis të tjerave edhe taksa për të pasurinë 96/16 e cila është truall dhe jo tokë arë.

Së treti Komisioni në vendimin e tij argumenton se adresa e treguar në lejen e mjedisit nuk është e njëjtë me atë të treguar në certifikatën e regjistrimit (NIPT).

Edhe ky argumentim i komisionit është në kundërshtim me ligjin dhe dokumentacionin që “Pinderi” shpk ka dorëzuar në tender. Ne kemi dorëzuar dokumentin me emërtimin “Leje mjedisore pdf”. Leja mjedisore që është dorëzuar është leja me nr. Serial PN-2795-05-2016 e cila ka të njëjtën adresë me atë që tregohet në certifikatën e regjistrimit (NIPT). “Pinderi” shpk ka vetëm një adresë kryesore në të cilën ushtron veprimtarinë. Kjo gjë provohet edhe nëpërmjet shënimeve të bëra në Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar. Në datën 17.05.2017 me nr. e cështjes CN-288269-05-17 sipas Ekstraktit Historik të Regjistrimit tregtar nuk është bërë ndryshimi i adresës kryesore por është përditësuar adresa e saktë sipas certifikatës së pronësisë që kërkohej nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve që është detyrim ligjor për tu njoftuar në adresën elektronike të tatimeve. Theksojmë se adresa kryesore dhe e vetme ku kryhet veprimtaria e “Pinderi” shpk është ajo që tregohet edhe Ekstraktin e QKB-së e cila korespondon dhe me adresën e treguar në lejen e mjedisit të dorëzuar. Në këto kushte të gjitha argumentimet e përdorura nga Komisioni i autorizuar për Shqyrtimin e Ankesës i Bashkisë Pogradec, janë abuzive të paligjshme dhe në kundërshtim me dokumentat e paraqitura në tender nga oe “Pinderi” shpk.

Bashkëlidhur gjithë këtij argumentimi do të paraqiten edhe dokumentat shoqëruese provuese të cilat Autoriteti Kontraktor Bashkia Pogradec nuk i merr parasysh.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 4152/2 prot., datë 24.11.2017 protokolluar me tonën me numër 1737/2 prot., datë 30.11.2017, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.



pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Pinderi” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “Në DST është kërkuar ”2.4.3 Te kete ne pronesi ose me qira, 1 (Një) automjet per transportin e druve te zjarrit”. Në përmbushje të këtij kriteri O.E “Pinderi” shpk ka paraqitur dokumentacionin e mjeteve me targa AA482 GR dhe AA617IR. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mjeteve rezulton se të dyja mjetet iu ka përfunduar certifikata e kontrollit teknik të mjeteve, konkretisht për mjetin me targa AA482GR certifikata e kontrollit teknik ka përfunduar me date 18.Gusht.2017 dhe për mjetin me targa AA617IR certifikata e kontrollit teknik ka përfunduar 20 Tetor 2017. Pra, O.E PINDERI SHPK nuk disponon asnjë mjet të rregullt me të cilin të kryejë levrimin e druve të zjarrit në shkollat e qytetit të Pogradecit dhe të Njesive Administrative. Referuar nenit 79 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të kalojnë në kontrollin teknik vjetor dhe atë periodik. Kontrolli teknik vjetor do të kryhet një herë në vit, për të gjitha mjetet me motor dhe rimorkiot. Për mjetet e reja me motor që hyjnë në Shqipëri, kontrolli i parë teknik do të kryhet brenda një viti nga data e regjistrimit. Pas kësaj periudhe ky kontroll kryhet për çdo vit.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.4.3. “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

2.4.3 Te kete ne pronesi ose me qira, 1 (Një) automjet per transportin e druve te zjarrit.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik “Pinderi” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- i. Mjeti me targë AA482GR.*
- ii. Mjeti me targë 617IR.*
- iii. Mjeti me targë 396KI.*
- iv. Mjeti me targë ACR596.*
- v. Mjeti me targë KO863B.*
- vi. Mjeti me targë ACR615.*

III.1.2.1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se:

Për mjetin me targë AA482GR operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar lejen e qarkullimit, Policën për Sigurimin e Detyrueshëm për Mjetet Motorike për Përgjegjësinë ndaj Palëve të Treta (Siguracionin), Certifikatën e Kontrollit Teknik i vlefshëm 18 gusht 2017, , Certifikatën Nr.46 datë 19.08.2017 “Për Transport Brenda Vendit për Llogari të Vet”, lëshuar nga Bashkia Komuna Drenovë (në përdorim të personit fizik Murat Pinderi).

Për mjetin me targë 617IR operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar lejen e qarkullimit, Policën për Sigurimin e Detyrueshëm për Mjetet Motorike për Përgjegjësinë ndaj Palëve të Treta (Siguracionin), Certifikatën e Kontrollit Teknik i vlefshëm 20tetor 2017, , Certifikatën Nr.21 datë 25.08.2014 “Për Transport Brenda Vendit për Llogari të Vet”, lëshuar nga Bashkia Komuna Drenovë (në përdorim të personit fizik/juridik Pinderi shpk).

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..”*

III.1.4. Nisur nga sa më sipër konstatuar, Komisioni gjykon se sa i takon kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, për mjetet rezulton se nuk është parashikuar në mënyrë shteruese i gjithë dokumentacioni që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë pjesmarrës në procedurën e

prokurimit (*leje qarkullimi, certifikatë pronësie e mjetit, certifikata e kontrollit teknik, vërtetim taksash vjetore (taksa të paguara) si dhe siguracioni dhe kolaudimi i mjeteve*). Detyrimi i autoritetit kontraktor për të përcaktuar qartësisht të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë në funksion të përmbushjes së kriterëve të përcaktuara në dokumentat e tenderit, është një detyrim i cili buron taksativisht nga ligji dhe akti normativ i dalë në zbatim të tij. Neni 27 “Kontratat e Mallrave” të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar parashikon shprehimisht se. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin.* Ndërsa neni 55 pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : « *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentat e tenderit* ».

III.1.5. Për më tepër nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik ankimues “Pindëri” shpk në përmbushje të kriterit të sipërcituar, në funksion të vërtetimit të kapaciteteve teknike ka paraqitur dokumentat, *Mjeti me targë AA482GR; Mjeti me targë 6171R; Mjeti me targë 396KI; Mjeti me targë ACR596; Mjeti me targë KO863B; Mjeti me targë ACR615;* nëpërmjet të cilave vërteton se nga pikpamja sasiore përmbush dhe tejkalon kërkesën e autoritetit kontraktor për mjetet e kërkuara. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në tërësi dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Pindëri” shpk, plotëson kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor.

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Pindëri” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*Në DST është kërkuar "Një dokument që vërteton që subjekti juaj, i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2016 dhe 2017, lëshuar Administrata e Qeverisjes Vendore". Në përmbushje të këtij kriteri O.E PINDERI SHPK ka paraqitur vërtetim nga Bashkia Korce me nr. 4441 prot, datë 24.10.2017, ku vërtetohet fakti se subjekti ka paguar vetëm tarifën lokale për vitin 2016 dhe 2017. Pra, operatori ekonomik PINDERI SHPK deshton se ka likuiduar vetëm tarifën lokale (vendore) dhe jo edhe*

taksat vendore, sic jane -Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.1 “Kapaciteti ligjor” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

Një dokument që vërteton që subjekti juaj, i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2016 dhe 2017, lëshuar Administrata e Qeverisjes Vendore. (Në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomike, secili anetar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik “Pinderi” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- i. *Vërtetim nga Bashkia Korçë nr. 4441 prot, datë 24.10.2017*
- ii. *Ekstrakt i regjistrimit tregëtar për të dhënat e subjektit “Pinderi” shpk si dhe Ekstrakt historik i regjistrimit tregëtar i shoqërisë “Pinderi” shpk;*

III.2.3. Neni 12 “Regjistrimi dhe Liçensimi” i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikon se: *Taksapaguesit, subjekte të këtij ligji, regjistrohen, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të regjistrimit, në përputhje me ligjin e posaçëm. Ndryshimet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe të të dhënave të tjera tregtare kryhen sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.*

III.2.4. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

III.2.5. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.*

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Korçë vërteton se operatori ekonomik “Pinderi” shpk ka shlyer detyrimet ndaj kësaj bashkie periudhën e specifikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, konkretisht vitin 2017, është autoriteti kontraktor Bashkia Korçë si organ i pushtetit vendor përgjegjës për detyrimet vendore dhe mban përgjegjësi për detyrimet e paguara ndaj tij nga subjektet e ndryshme, si organ me tagër në mbledhjen e të ardhurave të tij. Ky vërtetim ka dhënë informacion të mjaftueshëm për të

krijuar bindjen se subjekti në fjalë nuk është debitor i Bashkisë Korçë për taksat vendore të periudhës së lartpërmendur.

Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik, gjen me vend të theksojë, se në bazë të legjislacionit për prokurimin publik, autoriteti kontraktor i rezervon vetes të drejtën e verifikimit të dokumentacionit nëse autoriteti kontraktor do të kishte dyshime mbi operatorin ekonomik "Pinderi" shpk nëse ky i fundit ka detyrime pranë Bashkisë Korçë të çfardolloj natyre mund të bënte verifikimet e nevojshme në mënyrë që të provonte/faktonte se cilat ishin detyrimet konkrete që ky subjekt ka ndaj këtij autoriteti dhe t'ja bënte me dije ankimuesit. Akoma më tej referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues bashkëlidhur ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik vërteton se ka paguar taksat vendore pranë Bashkisë Korçë, vend ku ky i fundit ushtron edhe aktivitetin e tij.

Referuar kthim përgjigjes KSHA argumenton si vijon [...] *Së pari KVO-ja ka gjykuar drejt, pasi "Pinderi" shpk me vërtetimin e paraqitur nuk vërteton se ka paguar taksat vendore pranë Bashkisë Pogradec[..]*"

Operatori ekonomik ankimues në ankesën e paraqitur pranë KPP-së argumenton se [...] *Së dyti Komisioni në vendimin e tij argumenton se "Pinderi" shpk nuk vërteton se ka paguar taksat vendore pranë Bashkisë Pogradec. [...] Edhe këto argumentime të komisionit janë abuzive dhe në kundërshtim me dokumentat që opeartori ynë ekonmik ka paraqitur në tender. Operatorit ekonomik "Pinderi" shpk nuk mund ti kërkohet të paraqesë vërtetim që tregon se ka shlyer taksat vendore pranë Bashkisë Pogradec pasi ky është subjekti i regjistruar dhe që ushtron veprimtarinë e tij në territorin e bashkisë Korçë. Ky fakt provohet edhe ekstrakti i rregjistrimit tregtar lëshuar nga QKB-ja. "Pinderi" shpk ka depozituar në dokumentacionin e tenderit datë 26.10.20187 ora 16:37 vërtetimin lëshuar nga Bashkia Korçë ku tregohet se ky subjekt nuk ka detyrime të pashlyera ndaj Bashkisë Korçë.[...]*" Në këtë kuptim

Komisioni i Prokurimit Publik referuar argumentave të ankimuesit si dhe ekstraktit të regjistrimit tregëtar të subjektit, konstaton se ankimuesi nuk ka ushtruar aktivitetet në Bashkinë Pogradec duke mos i lindur në këtë mënyrë e drejta e kërkimit të vërtetimit pranë këtij autoriteti.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Pinderi" shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se "Në DST është kërkuar "Referuar Ligjit Nr.10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", i ndyshuar me ligjin Nr.60/2014, shtojca 1, A) ID 7.10 Veprimtarite e lendes se drurit - pika b., operatoret ekonomike duhet te jene te pajisur me licencen ose lejen përkatëse, gjithmone duke respektuar dispozitat e ligjit te sipercituar. Në leja me nr. serial PN-2795-05-2016 e paraqitur nga O.E PINDERI SHPK, vendi i kryerjes se veprimtarise eshte ne adresa: Stabiliment druri, rruga nacionale Korce - Erseke, Km i 4, perballe me fabriken e tullave. Nga verifikimi i ekstraktit te QKB rezulton se kane ndodhur ndryshimet e meposhtme ne Adresat e Aktivitetit: Ështe Shtuar Adresa: "Korce; KORÇE; ; Drenove; DRENOVE; Rruga Korce - Erseke, Km 4, Zona Kadastrale 1538, Nr. Pasurie 96/16, Tek Zapet; " Ështe Hequr Adresa: "Korce; KORÇE; Drenove; DRENOVE; Stabiliment druri,rruga nacionale Korçe-Erseke,km i 4-tert,perballe me fabriken e tullave. Për sa më sipër O.E PINDERI SHPK ushtron veprimtarinë e

lendes se drurit, shtojca 1, A) ID 7.10, në një adresë tjetër dhe jo në adresën e përcaktuar në leja me nr. serial PN-2795-05-2016”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.4.6. “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

Referuar Ligjit Nr.10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”, i ndryshuar me ligjin Nr.60/2014, shtojca 1, A) ID 7.10 Veprimtarite e lendes se drurit - pika b., operatorët ekonomike duhet të jenë të pajisur me licencën ose lejen përkatëse, gjithmone duke respektuar dispozitat e ligjit të sipercituar.

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik “Pinderi” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- i. Leje Mjedisi nr. serial PN-2795-05-2016 Tipi C për aktivitetin Prodhim i produkteve të përbëra tërësisht apo kryesisht nga druri nëq veprimtaria përfshin: sharrimin shpimin, fërkimin me rërë, gdhendjen, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit. Kodi III.1.A lëshuar më datë 18.05.2015 –Pa afat për subjektin Pinderi lëshuar nga QKB.(adresë: Stabiliment druri, rruga nacionale Korçë - Ersekë, Km i 4, përballë me fabrikën e tullave)*
- ii. Çertifikatën e rregjistrimit (NIPT) Pinderi, me adresë kryesore : Korçë Drenovë , Rruga Korçë Ersekë Km 4, Zona Kadastrale 1538. Nr. Psurie 96/16 tek Zapet*

III.3.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.3.4. Operatori ekonomik ankimues në ankesën e paraqitur pranë KPP-së argumenton se[...]*Së treti Komisioni në vendimin e tij argumenton se adresa e treguar në lejen e mjedisit nuk është e njëjtë me atë të treguar në çertifikatën e rregjistrimit (NIPT).*

Edhe ky argumentim i komisionit është në kundërshtim me ligjin dhe dokumentacionin që “Pinderi” shpk ka dorëzuar në tender.Ne kemi dorëzuar dokumentin me emërtimin “Leje mjedisore pdf”. Leja mjedisore që është dorëzuar është leja me nr. Serial PN-2795-05-2016 e cila ka të njëjtën

adresë me atë që tregohet në certifikatën e rregjistrimit (NIPT). “Pinderi” shpk ka vetëm një adresë kryesore në të cilën ushtron veprimtarinë. Kjo gjë provohet edhe nëpërmjet shënimeve të bëra në Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar. Në datën 17.05.2017 me nr. e cështjes CN-288269-05-17 sipas Ekstraktit Historik të Regjistrimit tregtar nuk është bërë ndryshimi i adresës kryesore por është përditësuar adresa e saktë sipas certifikatës së pronësisë që kërkohej nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve që është detyrim ligjor për tu njoftuar në adresën elektronike të tatimeve. Theksojmë se adresa kryesore dhe e vetme ku kryhet veprimtaria e “Pinderi” shpk është ajo që tregohet edhe Ekstraktin e QKB-së e cila korespondon dhe me adresën e treguar në lejen e mjedisit të dorëzuar. Në këto kushte të gjitha argumentimet e përdorura nga Komisioni i autorizuar për Shqyrtimin e Ankesës i Bashkisë Pogradec, janë abuzive të paligjshme dhe në kundërshtim me dokumentat e paraqitura në tender nga oe “Pinderi” shpk.

III.3.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit sa më sipër të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues Komisioni konstaton se në lejen me nr. serial PN-2795-05-2016 e paraqitur nga ky i fundit, vendi i kryerjes së veprimtarisë është në adresën: Stabiliment druri, rruga nacionale Korçë - Ersekë, Km i 4, perballe me fabrikën e tullave, ndërsa referuar Çertifikatës së rregjistrimit (NIPT) Pinderi shpk me adresë kryesore : Korçë Drenovë , Rruga Korçë Ersekë Km 4, Zona Kadastrale 1538. Nr. Psurie 96/16 tek Zapet, referuar sa më sipër Komisioni gjykon se është e njëjta adresë si në lejen mjedisore edhe në Ekstraktin e Regjistrimit. Akoma më tej Komisioni referuar edhe çertifikatës së pronësisë së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues konstaton se rezulton e njëjta adresë, por thjesht është bërë saktësim i zonës kadastrale, pra është përditësuar adresa e saktë sipas Çertifikatës së pronësisë , pasi adresa e vetme në të cilën operatori ekonomik ankimues ushtron aktivitetin e tij është adresa e cila është pasqyruar në Ekstraktin e Regjistrimit të lëshuar nga QKB-ja. Sa më sipër Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Pinderi” shpk me anë të dokumentacionit të paraqitur ka plotësuar kriterin e vecantë të kualifikimit.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Pinderi” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-28383-10-02-2017, me objekt: “Blerje dru zjarri”, me fond limit 9 268 000 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 27.10.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “Pinderi” shpk duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti Kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet Zyra e Financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Pinderi” shpk
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1737Protokolli, Datë 21.11.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha

